

Njoftim i përqendrimit me të cilin Filip Spasovski nga Republika e Maqedonisë së Veriut do të fitojë kontroll të plotë mbi Shoqërinë për distribuim dhe prodhim të energjisë elektrike EUROVIA SOLAR SHPKNJP Zhelinë nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

(lënda nr. 08-49/ 2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 09.03.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të plotë nga Filip Spasovski me seli në rr. Knez Trpimir nr.2 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut mbi shoqërinë për distribuim dhe prodhim të energjisë elektrike EUROVIA SOLAR SHPKNJP Zhelinë, me seli në rr.101 nr.15, Zhelinë, Republika e Maqedonisë së Veriut.

-Filip Spasovski është person fizik i cili në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Serbisë paraqitet si pronar i këtyre personave juridikë:

-Shoqëria për veprimtari grafike, tregti dhe shërbime POLIESTERDEJ SHPKNJP eksport import Shkup, me seli në rr. 1552 nr. 10, Shkup dhe me veprimtari prioritare –

-Shoqëria tregtare për përfaqësim, shërbime dhe tregti me shumicë dhe pakicë AKCENT MEDIA Agjencia Kombëtare e reklamave o.o. SHPKNJP import-eksport Shkup me seli në rr. NIKOLA TRIMPARE 39 LOK.1 Shkup dhe me aktivitet prioritar - Reklamim përmes mediave;

-Shoqëria për veprimtari grafike, tregti dhe shërbime DATA PRINT eksport import SHPK Shkup, me seli në rr. 1552 nr. 10, Shkup dhe me veprimtari prioritare 18.12- Printime të tjera;

-Shoqëria për tregti dhe shërbime POLI SOLARIS SHPKNJP Shkup, me seli në rr. 1552 nr. 10, Shkup dhe me veprimtari prioritare – Prodhimin e energjisë elektrike;

-Nju Imixh d.o.o. Beograd me seli në rr. Toshin Bunar 185, Beogradi i Ri, Republika e Serbisë dhe me aktivitet prioritar - printime tjera.

EUROVIA SOLAR SHPKNJP Zhelinë është shoqëri në të cilën ndryshohet pronësia dhe është shoqëri prodhuese e energjisë elektrike me seli të regjistruar në Zhelinë. EUROVIA SOLAR SHPK Zhelinë është themeluar në vitin 2021 dhe është në pronësi të një personi juridik EUROVIA HOLDING SHPK Zhelinë me pjesëmarrje prej 100% dhe depozitë në para prej 307,000,00 denarë. Shoqëria EUROVIA SOLAR SHPKNJP Zhelinë nuk figuron si pronare e subjekteve të tjera juridike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Shoqëria synon aktivitetin e saj kryesor ta kryej në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes ndërtimit të termocentraleve fotovoltaike që janë ndërtuar në terren në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përqendrimi ndodh në atë mënyrë që personi Filip Spasovski synon të bëhet pronar i vetëm i Shoqërisë për distribuim dhe prodhim të energjisë elektrike EUROVIA SOLAR SHPKNJP Zhelinë, dhe në këtë mënyrë të ushtrojë kontroll të drejtpërdrejtë dhe të plotë mbi punën e shoqërisë.

Ky përqendrim i referohet këtij tregu relevant: *Prodhimi i energjisë elektrike*.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

15.03. 2023

Shkup